

LEKSION I-II

KOMUNIKIMI GJUHËSOR DHE FUNKSIONET E GJUHËS

CËSHTJET:

1. Ç'është komunikimi.
2. Mesazhi-Kodi-Kanali.Dhënësi-Marrësi-Referenti
3. Funksinet e gjuhës: njohës, ekspresiv, fatik, konativ, poetik, performantiv.
4. Shenjat gjuhësore e jo gjuhësore.

1. Ç' është komunikimi

Në çdo rrethanë në të cilën ne gjendemi, ndodhemi në raport me dikë apo me diçka dhe vendoset kështu objektivisht një situatë komunikimi, ku përfshihen kushtet e komunikimit dhe arsyet se pse prodhohet një mesazh. Vihet kështu në lëvizje një rrjetë transmetimi mesazhesh dhe kjo gjë sjell si rezultat një modifikim të sjelljes sonë. Për të pasur komunikim, është e domosdoshme që të kemi diçka (një objekt, ngjarje) për të cilën të flasim dhe dikë me të cilin të hymë në marrëveshje. Komunikimi është një proces shoqëror dhe si i tillë merr kuptim dhe funksion si një shkëmbim autentik mes dikujt që transmeton informacion dhe atij që e merr dhe e interpreton këtë informacion.

Janë arsyet humane e shoqërore, të cilat na bëjnë që ne të komunikojmë. Është kusht i domosdoshëm që në komunikim të marrin pjesë dy a më shumë interpretë në një situatë preçize. Natyra e komunikimit shoqëror na lejon që në çdo rast ne mund ta verifikjmë atë brenda një komuniteti të organizuar ku bëjnë pjesë interpretët (pra duhet të paktën dy interpretë) dhe një kod komunikimi i përbashkët. Duke u nisur nga një qëllim ne transmetojmë e marrim kështu informacione.

Në botën e gjallë, duke përfshirë edhe shoqërinë njerëzore, përdoren forma dhe mjete të ndryshme komunikimi. Ndër këto mjete, dallohen dy grupe të mëdha: sistemet e shenjave që përdoren në shoqërinë njerëzore dhe sistemet e shenjave karakteristike për botën shtazore.

Në sistemin e shenjave që përdoren për komunikim në shoqërinë njerëzore janë të shumëllojta duke nisur me gjestet, sinjalet zanore (fishkëllimat, sinjalet me bri, daulle, me të shtëna), sinjalet me dritë, me flamur etj, shenjat rrugore, alfabeti mors, simbolet kimike, të fizikës e deri tek mjeti kryesor i komunikimit, gjuha.

Këto sisteme shenjash mund të ndahen në tri grupe të mëdha. Në grupin e parë mund të futen sistemet e shenjave që zëvendësojnë plotësisht gjuhën. Këtu hyn alfabeti mors etj.

Një grup tjetër formojnë ato sisteme që e shoqërojnë të folurit tonë, të cilët mbështeten tek gjuha, por nuk e zëvendësojnë plotësisht atë. Këtu hynë gjestet, lëvizjet e trupit etj.

Në grupin e tretë përfshihen gjuhët speciale, si gjuhët logjike e gjuhët e programimit, të cilat përdoren nga logjicienët, inxhinierët. Këta quhen gjuhë artificiale.

Ndër të gjitha këto gjuha është sistemi semiotik më i rëndësishëm dhe më universal. Të gjitha sistemet e tjera të shenjave që përdorin njerëzit, ndërtohen mbi bazën e gjuhës dhe “lexohen” nëpërmjet saj. Prej kësaj mund të pohojmë se gjuha është sistemi më i plotë dhe më i rëndësishëm që përdoret dhe mjeti themelor i komunikimit.

Komunikimi i kafshëve

Procesi i komunikimit të kafshëve karakterizohet nga një sistem simbolik nga më elementarët. Ky komunikim karakterizohet nga përsëritja (ritualiteti). Përdorimi i kodit ose sistemit të shenjave në komunikimin e kafshëve janë të lidhura dhe të kushtëzuar nga stimujt, gjë që e bën këtë komunikim të përsëritshëm dhe jo autonom, pra ky komunikim është i privuar nga liria dhe kreativiteti, karakteristika këto themelore për komunikimin njerëzor. Komunikimi njerëzor njihet pavarësi nga stimujt.

II. Mesazhi-Kodi-Kanali.Dhënësi-Marrësi-Referenti

Asnjë lloj veprimtarie njerëzore nuk mund të mendohet pa shkëmbimin e mesazheve. Edhe format e tjera të komunikimit të shoqërisë njerëzore (si shkëmbimi i mallrave etj) nënkuptojnë gjithmonë komunikimin e mesazheve. Pra, të komunikosh, do të thotë të jetosh, dhe të jetosh, do të thotë të komunikosh.

Qëllimi i çdo komunikimi me anë të një sistemi çfarëdo shenjash është transmetimi i informacionit. Mënyrat e komunikimit janë të shumta dhe të shumta janë informacionet që u përcillen të tjerëve me anë të tij. Çdo akt komunikimi sado i thjeshtë qoftë, përbën një dukuri të ndërlikuar që nënkupton bashkëveprimin e një vargu faktorësh, pa të cilët komunikimi do të ishte i pamundur. Në çdo lloj komunikimi janë të pranishëm këta përbërës: dhënësi, marrësi, mesazhi, referenti (tema, argumenti), kodi dhe kanali. Kemi një akt komunikimi sa herë që ndodh kalimi i informacionit nga dhënësi te marrësi, me një fjalë *kur një dhënës shfrytëzon një kanal të caktuar komunikimi për t'i dërguar marrësit një mesazh rreth një referenti të caktuar, duke përdorur shenja të një kodi që e njohin të dyja palët.*

Që komunikimi të realizohet me sukses duhet që marrësi jo vetëm ta përhapë mesazhin, por edhe ta zbërthejë përmbajtjen e tij, d.m.th. ta **shkodojë** mesazhin e **koduar** nga dhënësi. Për të kuptuar mesazhin nuk mjafton vetëm njohja e referentit, por edhe e sfondit, e kuadrit të përgjithshëm në të cilin vendoset ai. Ky sfond në të cilin ndodh komunikimi, përbën **konteksti** e komunikimit. Konteksti i komunikimit është i domosdoshëm për t'u kuptuar mesazhi nga marrësi.

Konteksti mund të jetë gjuhësor ose jashtëgjuhësor. Konteksti është gjuhësor kur domethënia e mesazhit nxirret nga teksti. Konteksti jogjuhësor quhet zakonisht situatë e ligjërit. Në këtë rast, përmbajtja e mesazhit zbërthehet duke u mbështetur në rrethanat e jashtme në të cilat ndodh komunikimi. Komunikimi zhvillohet sipas kësaj skeme:

KANALI



KANALI

KODI = GJUHA

Thëniet që prodhohen në aktet e komunikimit kanë funksione të ndryshme të cilat janë të kushtëzuara nga përbërësit e komunikimit. Sipas, R. Jakobsonit, me çdonjërin prej gjashtë përbërësve të komunikimit lidhet një funksion gjuhësor i veçantë:

REFERENCIAL (referenti)

EKSPRESIV (dhënësi)	FATIK (kanali)	POETIK (mesazhi)	FATIK (kanal)	KONATIV (marrësi)
------------------------	-------------------	---------------------	------------------	----------------------

METAGJUHËSOR (kodi)

Kjo lidhje nuk do të thotë që çdo mesazh verbal ka vetëm një funksion gjuhësor. Thëniet me një funksion gjuhësor janë të rralla.

III. Funksinet e gjuhës

Nga funksionet më kryesrë të gjuhës mund të përmendim:

Funksioni njohës

Ky funksion lidhet me referentin a kontekstin e komunikimit, prandaj quhet edhe **referencial**. Sipas gjuhëtarëve ky është funksini kryesor. Një thënie ka funksion njohës kur përdoret si mjet për të na dhënë informacion për referentin, d.m.th. për diçka në botën që na rrethon. Ky informacion jepet në formën e pohimeve, që shprehen me anën e fjalive dëftore. Kur gjuha përdoret në këtë funksion, qëllimi është që të pohohet diçka që mund të jetë e vërtetë ose jo. *Uji ngrin në 0°* (pohim i vërtetë), *Kali është kafshë mishngënëse* (pohim i rremë). Tek fjalitë dëftore mund të zbatohen kriteret e vërtetësisë, ndërsa tek fjalitë pyetëse, urdhërore nuk mund ta zbatojmë.

Funksioni ekspresiv

Funksioni ekspresiv (shprehës, emotiv) lidhet me dhënësin e mesazhit. Kur përdoret me këtë funksion gjuha shërben për të zbuluar ndjenjat, qëndrimet e folësit rreth asaj që kumton. Bartëse tipike të këtij funksioni janë pasthirrat p.sh.: *Obobo! Qyqja!* Por edhe ndërtime të tjera mund të përdoren në këtë funksion p.sh. fjalitë me një folje që shpreh gjendje shpirtërore: *U gëzuam shumë kur morëm vesh se....*

Funksioni fatik

Gjuha përdoret me funksion fatik atëherë kur me anë të saj synohet të vendoset kontakti midis folësit dhe dëgjuesit ose të verifikohet nëse kanali i komunikimit funksionon. P.sh. shprehja *Alo!* e përdorim në telefon me qëllim që të sigurohemi se po na dëgjon, ka gjithashtu edhe shprehje të tjera, si *që thua ti, domethënë* etj. Përsëritet e mirëseardhjes, si: *Mirëmëngjes! Mirë se rrini!* Etj. Shërbejnë për të hyrë në komunikim. Shprehjet *Si je? Si ia çon?* Nuk janë aq shprehje e interesit për të mësuar për shëndetin e tjetrit, por e shprehjes së mirësjelljes, e dëshirës për t'u treguar i njerëzishëm dhe i gatshëm për një komunikim normal.

Funksioni konativ

Ky funksion lidhet me marrësin. Meqenëse shprehet me fjali urdhërore e thirrmore, shumë gjuhëtarë flasin për një funksion urdhërues (imperativ) ose evokativ. Gjuha përdoret me funksion konativ kur duam të nxisim dëgjuesin të bëjë diçka. Tipike për këtë funksion janë fjalitë nxitëse me folje në mënyrën urdhërore, si p.sh. *Mbylle derën! Qetësi!* Urdhëri mund të zbutet duke i shtuar fjalisë shprehjen *ju lutem*.

Thamë se disa gjuhëtarë e quajnë këtë funksion evokativ, duke u nisur nga ajo që me këtë funksion gjuha përdoret për të krijuar ndjenja dhe gjendje të caktuara emocionale tek dëgjuesi p.sh. shakatë.

Funksioni poetik

Kur theksi vihet mbi vetë mesazhin, kemi të bëjmë me funksion poetik të gjuhës. Funksioni poetik nuk është i vetmi funksion i artit të fjalës, po vetëm funksioni mbizotërues i tij.

Funksioni performativ

Ky funksion ka të bëjë me realizimin e përmbajtjes së një mesazhi verbal. Gjuha përdoret në këtë funksion kur, duke shqiptuar fjalë të caktuara, duam të shënojmë fillimin e një veprimi p.sh. në fillim të një konference, kryetari deklaron: *“Konferencën e deklaroj të hapur”*. Pra, që të realizohet funksioni performativ, duhet që mesazhet gjuhësore të përdoren në vendin dhe në kohën e duhur dhe nga persona që janë ngarkuar për të nxitur fillimin e diçkaje a konkretizimin e një pohimi p.sh. kryetari i seancës ka të drejtë të hapë e të mbyllë seancën.

Funksioni metagjuhësor

Sa herë që folësi ose dëgjuesi duan të verifikojnë nëse janë duke përdorur të njëjtin kod, kemi të bëjmë me funksionin **metagjuhësor** (metalinguistik) të gjuhës. Ky funksion mund të kuptohet më lehtë, nëse do të kemi të qartë dallimin midis dy përdorimeve të gjuhës: kur përdoret për të folur për objektet dhe kur përdoret për të folur për atë vetë. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me **metagjuhën**, me të cilën duhet kuptuar përdorimi i gjuhës për të

folur për vetë gjuhën p.sh. “Ç’është **tramvaji**?,- pyet fëmija prindin.” “**Tramvaji** është mjet që lëviz mbi shina”, - përgjigje prindi. “Po **mjet** ç’do të thotë?”. “**Mjet** është autobusi, treni etj.”. E gjithë biseda përban të dhëna për kodin leksikor të shqipes, pra funksioni metagjuhësor lidhet me kodin. Fëmija i vogël verifikon dhe plotëson me shenja kodin e vet, me qëllim që të kuptojë mesazhin.

Kodi, shenjat, mesazhi

Termet kod dhe mesazh, që i përkasin teorisë së komunikimit, përdoren shpesh si sinonime të fjalëve gjuhë dhe ligjërim. Kështu, gjuha mund të shihet si një kod i përbashkëtpër të gjithë anëtarët e një bashkësie gjuhësore, kurse ligjërimi, si proces i përdorimit të këtij kodi, i përgjigjet mesazhit. Çdo kod na paraqitet si një sistem shenjash që shërbejnë për ndërtimin dhe shkëmbimin e mesazheve. Rrjedhimisht, edhe gjuha, si kodi më universal i komunikimit, është gjithashtu një sistem shenjash.

Shenjat jo gjuhësore janë të natyrave të ndryshme. Ato ndahen në simptoma, simbole dhe ikona.

Shenjat simptoma janë dukuri natyrore, të përceptueshme, që paralajmërojnë dukuri të tjera të cilat nuk i përceptojmë drejtpërdrejt ose që mund të ndodhin më vonë. P.sh retë e zeza janë shenjë e stuhisë, ngritja e temperaturës së trupit mund të jetë simptomë e sëmundjes etj.

Ikonat janë shenja që ngjajnë pak a shumë me objektin që shënojnë, si p.sh. hieroglifet, shumë shenja orientuese publike, diagramet etj.

Simbolet janë shenja tek të cilat vërehet një lidhje qoftë edhe e dobët me objektin që shënojnë p.sh. dafina si simbol i paqes, peshorja si simbol drejtësisë. Po në një kuptim më të gjerë simbole konsiderohen edhe shenja të tilla arbitrare, si simbolet kimike, matematike, shkronjat e alfabetit, të cilat nuk kanë lidhje shkakësore me objektin që shënojnë.